

**TWO UNKNOWN MANUSCRIPTS IN THE FIELD OF
LEXICOGRAPHY
DY DORËSHKRIME TË PANJOHURA NË FUSHË TË
LEKSIKOGRAFISË**

Begzad BALIU¹

¹ Faculty of Education, University of Prishtina „Hasan Prishtina”

**Corresponding author e-mail: begzad.baliu@uni-pr.edu*

Emanuel Krajinovič, *Albansko – srpskohrvatski/ Srpskohrvatski –albansko*,
dorëshkrim, Letnicë, 1960.⁶⁰

Kohë më parë më ra në dorë një dorëshkrim i lidhur i dy fjalorthëve dygjuhësorë, ose sikur shkruhet në ballinat e tyre: “Fjalor i vogël shqip-serbokroataisht” dhe “Fjalor i vogël kroatoserbisht –shqip”. (Origjinal: “Mali rječnik albansko-srpskohervatski” dhe “Mali rječnik hervatskosrpski albanski”). Autori i këtyre dy dorëshkrimeve është një nga personalitetet e shquara të jetës politike, intelektuale dhe fetare dr. Emanuel Krajinović (1891-1981), pastor-dekan, atëherë në kishën katolike të Letnicës, në Kosovë, ku shërbeu nga viti 1953 deri në fund të jetës së tij, 1980. Sikur mund të shihet nga faqja e fundit e dorëshkrimit, ky fjalorth, ka përfunduar së përgatituri në fillim të marsit të vitit 1960 dhe është botuar po brenda këtij viti. Megjithëse ky dorëshkrim, ndryshe nga botimet e tjera të është shtypur në disa ekzemplalë modestë me makinë, biografët dhe bibliografët e tij, edhe si të tillë e konsiderojnë si botim më vete, pavarësisht se kopjet e tij mund të mos i kenë kaluar më shumë se disa dhjetëra sish.

⁶⁰ Përshkrimin dhe krahasimin e plotë të dorëshkrimit e bëri studiuësja e re Zamira Sokoli, për çka i jam mirënjohës.



Në kërkim të biografisë së dr. Emanuel Krajinović-it kam vënë re se ato përgjithësisht janë të ndara në dy profile. Në profilin e parë dr. Emanuel Krajinović-i paraqitet nga prizmi i prelatit që ka kryer detyra me përgjegjësi kishtarë; në profilin e dytë dr. Emanuel Krajinović-i paraqitet jo vetëm si një prift i përkushtuar në raport me kishën po edhe me angazhime politike e ushtarake gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke shtuar këtu edhe aktivitetet e tij prej publicisti e përkthyesi.

Besoj se kjo është edhe një prej arsyeve pse biografia e Krajinovićit ende nuk është përfshirë në Enciklopedinë e Kroacisë, ndërkohë që biografia e tij mund të lexohet në shumë botime jo vetëm të karakterit shkencoror.⁶¹

Emanuel Krajinović lindi në Kiseljak (23.3.1891) dhe vdiq në Letnicë (16. 2. 1981). Shkollimin fillor e mori në vendlindje, gjimnazin në Visoko, ndërsa studimet për teologji i vazhdoi në Sarajvë dhe Budapest. Pas mbarimit të studimeve ai u emrua prift në vitin 1914 dhe më tej profesor në Visoko (1917-1922) për të kaluar për pak kohë ligjërues i teologjisë në Sarajevë pastor në Podhum afër Konjices dhe sekretar i provincës. Një prej personaliteteve të formuara dhe të shkolluara të kohës me një arsim të lartë fetar e intelektual dr. Emanuel Krajinović deri në prag të Luftës së Dytë Botërore ishte ftuar të bashkëpunonte me disa revista të kohës, qoftë me karakter fetar, qoftë me karakter laik në hapësirën jugosllave.


Ai do të shquhet gjatë kësaj kohe jo vetëm për artikujt me karakter fetar po edhe për polemikat e ashpra. Një aspekt tjetër të botimeve të tij janë veprat dhe sidomos përkthimet nga gjermanishtja, hungarishtja dhe frengjishtja. Bashkëkohësit e tij me kohë kishin vënë re prirjen e tij për të zotëruar gjuhë të ndryshme, për t'i përdorur ato me gojë e me shkrim dhe në mënyrë të veçantë për të përvetësuar jo vetëm leksikon po edhe strukturën gramatikore të tyre.

Nga veprat e tij do të theksojm veprën e parë *Lutje dhe këshilla për ushtarët gjatë luftës* (Zagreb, 1914); përkthimin e veprës së personalitetit të shquar të kohës Tihomir Totha *Krishti dhe të rinjtë* (Mostar, 1934), ndërsa vepra tij *Çallma e madhe* (Sarajevë, 1930) do të bëhet një nga veprat më të diskutuara të kohës. Jeta e Emanuel Krajinovićit do të marr orientim më kompleks kur gjatë Luftës së Dytë Botërore në Sarajevë do tju bashkohet forcave nacionaliste kroate dhe do të shërbej në krahun e tyre deri në vitin 1945, kur për veprimtarinë e tyre do të marr denim maksimal nga shteti komunist jugosllavë.

Në vitin 1951 do të përfitoj nga ligji për rehabilitimin e bashkëpunëtorëve të luftës dhe jeta tij do të marr një drejtim krejt tjetër. Strukturat më të larta kishtarë dr. Krajinovićin do ta dërgoj fillimisht në Dioçezën e Shkupit, me shërbim në Manastir(1951), pastaj në Mitrovicë dhe pastaj në Dioçezen e Prizren -Shkup, me shërbim në Letnicë të Kosovës, ku do të shërbejë deri në fund të jetës, në vitin 1981. Varrimi i tij në vendlindje afër Sarajevës u bë me nderime të mëdha kishtarë nga Dioqeza Prizren-Shkup dhe nga Dioqeza e Sarajevës. Kërkimet e reja na bëjnë të ditur që edhe kjo është vetëm njëra anë e biografisë së tij.

⁶¹ Për biografinë dhe bibliografinë e dr. Emanuel Krajinovićit u jam referuar veprave dhe zërave elektronik: Frrok Zefi, Zupa Letnica, 2017, f. 94-95; Redaksia, *Dr. Emanuel Krajinović*, "Glas Koncila", nr. 5/1981, Zagreb, 1981, f. 10; Leksikon iseljenistva - web izdanje <http://fotoimago.hr/Flip%20PDF/mobile/index.html#p=729>, f. 729; Andrija ŽIVKOVIĆ, *Emanuel Krajinović, Veliki turban - pod njim hodže nema ili Vidovićevo prosvjetno-etički pokret*, Štamparija Obod, Sarajevo, 1930, f. 253. *Hrvatski franjevački biografski leksikon*, Redaktorë: Franjo Emanuel Hoško, Pejo Čošković, Vicko Kapitanović, Zagreb, 2010, f. 394 (web).

Pas rrafshit të angazhimit fetar deri në prag të Luftës së Dytë Botërore dhe pas rrafshit nacionalist të angazhimit të tij gjatë kësaj lufte, si dhe pas rrafshit të angazhimit kishtar në Kosovë gjatë 30 viteve të fundit, në shtypin ditor të Beogradit së fundi shfaqet edhe një anë e panjohur e biografisë së dr. Emanuel Krajnqeviqit. Njëri prej politikanëve serb të periudhës së komunizmit të viteve '60 dhe '70 së fundi deklaroi se në zgjerimin e autonomisë së Kosovës së vitit 1966-1974, kishte dorë edhe Vatikani dhe një prej personaliteve kishtarë, dorë e zgjatur e Vatkinait në Kosovë, Emanuel Krajnqeviq. Në këtë rrafsh mbetet në dorën e historianëve dhe biografëve të tij që të merren me plotësimin e biografisë së tij me këtë pjesë të angazhimeve të Krajnqeviqit për Kosovën dhe shqiptarët. Shenja të rëndësishme të këtij angazhimi dhe nderim kombëtar e kulturor të këtij angazhimi Emanuel Krajnqeviqit ka shfaqur në vitin 1960 kur ai përgatiti dorëshkrimin e dy fjalorthëve: “Fjalor i vogël shqip-serbokroataisht” dhe “Fjalor i vogël kroatoserbisht –shqip”.



Nuk mund të themi se ka shumë arsye për të sjellë të dhëna karakteristike të këtij dorëshkrimi të shtypur në disa kopje modeste me makinë, e megjithatë e konsiderojmë të theksojmë disa karakteristika. Fjalorthët hapen me një *listë shkurtësash* gramatikore dhe me disa *vërejtje, shënime dhe komente*, gjithashtu të karakterit gramatikor. *Fjalor i vogël shqip-serbokroataisht* ka rreth 1250 fjalë, ndërsa *Fjalor i vogël kroatoserbisht –shqip* rreth 830 fjalë

Ajo që të bën përshtypje që në fillim është se si ai e shkruan në vitin 1960 etnonimin shqiptar. Në një që etnonimi shqiptar kudo në aktet normative, në dokumentet e administratës, në literaturën shkencore nga autorë sllavë dhe shqiptarë shkruhej si *shiptar/i* dhe madje *shiftari*, në këtë *Fjalorth* shënohet një trajtë më e përafërt *shqyptarë*, -ët: **Albanac**, *m.* = Shqyptarë- i, Shqyptarë-t; **Albanka**, *ž.* = Shqyptare-ja, Shqyptare-t; **narod, nacija**, *m.ž.* = komë-i, pl. komë-t.; **albanski**, *adv.* = shqyp; albanski jezik = shqype-ja; megjithëse etnonimi *šiptari*, del dy herë si term plotësuese: **shqype-ja**, *ž.*— orao(ovo znači i albanski jezik, šiptarski) dhe **shqyp-e**, *adj.* - albanski, šiptarski.

Do theksuar gjithashtu se edhe etnonimi serb është shënuar në trajtën popullore *shkja*: **Shkjaa-u; shkjee**, *m.* - slaven. Të menduar si dy *Fjalorë* me karakter praktikë këto dorëshkrime që si të tilla ma gjasë edhe kryen sado pak funksionin e tyre, qoftë edhe në nivele të Famullisë, kanë edhe rëndësinë e tyre me karakter gjuhësor dhe madje tematikë, qoftë për rëndësinë e përdorimit të tyre, qoftë për rëndësinë e trajtave gjuhësore të përdorura.

Le të shohim fillimisht aspektin tematik të leksikut duke e parë atë në kontekstin e zbatimit praktik të fjalorthit. Në radhë të parë kemi identifikuar **emrat e farefnisnë**: **aat, ati**, *pl.* - aten, etnit, *m.* - otac; **Âmë-a**, *ž.* - mati, majka; **babë-a**, *a, m.* - otac; **biir, biri, birt**, *m.* - sin; **binjok-u**, *ë, m.* - blizanac, dvojak; **fis-i**, *e, n. m.* - rod, tribus, fis; **gjyshe-ja**, *ž.* - baka; **gjysh-i**, *a, m.* - djed, dedo; **kunat-i**; **kuneten, kunetnit**, *m.* - svak, djever, pašnac, rođak; **mòter, motra**, *a, ž.* - sestra; **nanë-a**, *a,ž.* - majka, mati; **prind-ja; prind-i, prind-t** - roditelji; **teze-ja(êmtë-a)**, *ž.* - tetka (materina sestra); **vllaa-u; vllazen-znit**, *m.* - brat etj.

Fjalë të motivuara nga leksiku tradicional: adet-i (zakon-i), *e, m.* - običaj; **besë a**, *ž.* - Trenë, ugovor, pogodba, primirje; **bee-ja**, *ž.* - zakletva, prisega; beeja n' rrenë - kriva zakletva; **fejue(me)**, *va.* - zaručiti, prstenovati, obećati (se); **odë-a**, *a,ž.* - soba, odaja, komora; oda e zjermit- kuhinja; oda e miqve- primaća soba (za primanje); **vade- ja**, *ž.* - rok, odgoda; **zakon-i**, *e, m.* - običaj, navika, zakon etj. Po kështu identifikojmë emrat e instrumenteve **frula**, *ž.* = fyell-fylli, *pl.* fej-t; kavall- kavalli, *pl.* kavaj-t. të cilat, ndonëse këtu paraqiten të ngjashme, por në të vëretë nuk janë të njëjta, porse autori në serbo-kroatisht i ka shënuar me një term të vetëm.

Emra vendesh, në të cilin të bën përshtypje një emër qytetit Asiz, trajta italiane e qytetit të Durrësit, trajta dielktore e emrit të qytetit të Stambollit dhe tri emërtimet e tij historike, trajta italiane e emtit të Trishtes, emërtimi mesjetar i Dubrovnikut si njësi bazë në gjuhën shqipe etj.: **Afrikë-a**, *ž.* - Afrika; **Amerikë-a**, *ž.* - Amerika; **Asizë-i**, *m.* - Asiz (grad); **Azii- a**, *ž.* - Azija; **Bûnë-a**, *ž.* - rijeka Bojana; **Beçe-a**, *ž.* - beç; **Drîi, Drini**, *m.* - Drin(rijeka); **Drisht** - *im.* - Drivast; **Durrëci-i**, *m.* - Durazzo, Draç; **Evropë- a** *ž.* - Evropa; **Mali i Zii**, *m.* - Crna Gora; **Milani-i**, *m.* - Milano; **Raguzë-a**, *ž.* - Dubrovnik (Raguza); **Romë-a**, *ž.* - Rim; **Stamolë-a**, *ž.* - Istanbul, Carigrad, Konstantinopol; **Shkòder-a**, *ž.* - Skadar; **Trijeshtë-a**, *ž.* - Trst(Triest); **Venedik-u**, *m.* - Venecija, Mleci; **Gjermane- ja**, *ž.* - Njemačka, germanija etj.

Sikur mund të shihet në shqipen, fjala **Gjermane-ja**, *ž.*, do të shënonte një emër personi dhe do të lakohej si e tillë: *i, e (një) gjermanes, (një) gjermane-n*, etj., mirëpo për të shënuar vendin, do të përdorej si **Gjermani-ja**, ashtu siç edhe e ka shënuar në gjuhën kroate, autori. Të kësaj natyre janë edhe ojkonimet e *Fjalorit Serbokroatisht-shqip*; **Baçalek**, *m.* - Baçallek-u (selo kod Skadra); **Berdica**, *ž.* - Berdicë/a (seoce kod Skadra); **Draç(Dyrrhachium)** = Durrës-Durroi(Draç, grad u Albaniji) etj.

Njësi leksikore me bazë emrat nacional dhe simbolet identitare: flamur- i, *m.* - zastava, stijeg; **giuhë- a** *ž.* - jezik, govor; **inglizçe-ja**, *ć.* - engleski jezik; **tedeshqe-ja**, *ž.* - njemački, njemački jezik; **italijançe-ja**, *ž.* - italizanski jezik; **shqype-ja**, *ž.*— orao(ovo znači i albanski jezik, šiptarski); **Malazias-i; malazezë**, *m.* - Crnogorac; **Shkjaa-u; shkjee**, *m.* - Slaven; **Turk-u; Turq**, *m.* - Turčin etj. Në këtë listë të përdorimit të fjalëve, autori ka përdorur edhe termin **šiptarski** (*si shpjegim shitesë*), term përbuzës që është përdorur në Jugosllavi për

shqiptarët, pavarësisht se u referohet si **Albanac** në pjesën e dytë të fjalorit, e jo me këtë term. Gjithashtu ka përdorur edhe trajtën zbnuese: *shkja-u; shkjee*, si trajtë të parë përdorimi.

Fjalë që përcaktojnë nocione gjeografike/ dukuri natyrore: **botë-a**, ž.- svijet, zemaljska kugla; **breg-u**; *pl. bregje, m.* – obala, igalo; **brîi- a**, ž.- strana, bok; per brîi, - sa strane, s boka; **detë-i, detna, m.** – more, pučina; **diill-i m.** – sunce; **dritë-a, dit.** ; z. – dan; gjith ditën – cijeli dan; - per ditë- svakodneвно; **dritë-a, ž.** – svijetlo, sjaj, dan; **dyrnjâa- ja (shëkull-i) , (rruzullim-i) , ž.-** svijet, vasiona, svemir; **dhee- u , m.** – zemlja; **eer, era; erna, ž.-** miomiris; **fushë-a, ž.** – ravnica, polje; **grykë-a a, ž.** – grlo, ušće, zjalo; me marrë ngrykë- zagriliti; **hanë-a, ž.** – mjeseć; **havaa-ja(ajr-i) ž.-** zrak, vazduh; **hylli; hyj, m.** – sviježda, zviježđe; **knetë-a, a, ž.** močvara, bara, blato, glib; **kòder, kodra, a, ž.** – brežuljak, hum; **krue, kroni; kroje, m.** – izvor, vrelo; **liqëe-ni, e, m.** – liqej, m. – jezero, blato; **lug-u; lugje, m.** – kanal, dolina; **mal-i, e, m.** – brdo, brijeg; **mot-i; motna, mote, m.-** vrijeme; **natë-a; net ž.-** noć; nâten- po noći, u noćno vrijeme; **natyrë-a, ž.-** narav, ćud; **oceanii-a, ž.** – oceanija; **pyllë-a, pyllna, ž.** –šuma, gora, dubrava, gaj, zabran; **shpat-i e,m.-** strmina, obronak, gaj, lug, dubrava, šuma, zašumlje; **shterngatë-a, a, ž.-** pljusak, **tokë-a, ž.-** zemlja, tlo; **terr-i, m.-** tama, mrak, tamnina; **termek-u; termeqe,m.-** potres, trus, zemljotres; **shterngatë-a, a, ž.-** pljusak; **ylberë-i e,m.-** duga etj., si dhe në Fjalorin serbokroatisht-shqip: **brijeg(žal, obala) , mž.=** breg-bregu, *pl. bregje-t; buzë-buza pl. buzë etj.* Të bie në sy edhe këtu prania e fjalëve me karakter dialektor krahas atyre që kanë fituar një shkallë më të lartë letrare edhe në letërsinë artistike.

Fjalë që tregojnë vendbanime: **gjytet-i e, m.** – grad, varoš, mjesto; **katund-i, e, m.** – selo; **kalaa-ja(gjytetzë-a), ž.-** utvrda, tvrđava, kula; **hotel- a, a, ž.-** hotel, konak, gostionica. - Në fjalët që shënojnë vendbanime, vlen të përmendet fjala **gjytet-i** dhe **gjytetzë-a**, në aspektin fonetik, për shkak të afërsisë së vendit të shqiptimit që i kanë bashkëtingëlloret **q** dhe **gj**, autori ka shënuar **gj** në vend të **q**.

Fjalë që tregojnë monedha dhe lloje metalesh: **frank- u, ë, m.** – franak (novac); **koronë-a, ž.** – kruna (novac); **metelik-u, e, m.** – metelik (turski novac od oko 6 para); **pare-ja, ž.-** novac, kovani movac; **aar, ari, m.** – zlato; **çelik-u, m.** – çelik, nado, mazija; **hëkur-i a, m.** – željezo etj. **Fjalë të aspektit fetar/ shpirtëror/:** **apostull-i, m.** – apostol; **bekim-i; e, m.** – blagoslov, beriçet, sreća; **bekue (me), va.** – blagosloviti; **falë (m'u) vr.** – pozdraviti, me ju falë ndeërës- zahvaljivati kome; falemi ndeers- zalivaljujem; **falun-it (t'), n.** – pozdrav, ponuda, oproštaj; **famullii-a , ž.** – župa; **frat-i; freth , fretnit, m.** – franjevac, redovnik, monah; **hoxhë-a, a, m.** – hodža, turski svećenik; **ipeshkv-i; ipeshkvi, m.** – biskup; **kishë-a, ž.-** crkva, hram; **Krisht-i, m.** – Krist; **krishtën(i, e) , adj.** – kršćanski; **lametenzonë, adv.** – sbogom; **Kryq-i a, m.** – Krucifiks, propelo; **minare-ja, ž.-** munara; **Monastirë-i , m.** – Monastir (Bitola); **ramazan-i, m.-** ramazan (muslimanski post); **sh'(shejti) ,m.-** svet, svetac; **shêjtan-i, a, m.-** vrag, đavao; **shêjt-i; shêjten-nit m.-** svetac; **shelbue(me) , va.** – spasiti, otkupiti; **shelbues-i a,m.-** Spasitelj, Otkupitelj; **shpirtë-i; shpirtna, m.-** duh, duša; **Tenzonë(me) s Bogom;** me Tenzon vosh e kJosh- zbogom; **xhamii-a, ž.-** džamija, mošeja; **Zot-i a,m.-** B O G; **xham-i a, m.-** staklena ploča, okno etj.

Të bën përfshypje fakti se fjalë me karakter fetar edhe pse autori vetë ka qenë prift me profesion, këtu ka përfshirë fjalë edhe të besimit islam. Shikojmë gjithashtu që për shënjimin e disa shprehjeve të besimit katolik i ka shkruar me shkronjë të madhe për dallim nga ato të besimit islame i shkruan me shkronjë të vogël. Po kështu është gjendja edhe në *Fjalorthin serbokroatisht-shqip*: **andëo, m.=** êjll-i, *pl.-* êj-t; **bajram, m.-** bajram-i, bajrama-t = muslimanska svetkovina; **BOŽIĆ, m. =** KSHNDELLAT; **Božićna svetkovina, ž.=** Dita e Kshndellave; **GOSPIDIN BOG=** ZOTYNË etj.

Edhe këtu vërehet dallimi që bën autori, kur shkruan për festat e myslimanëve dhe ato katolike. Festat katolike i shkruan me shkronjë të madhe, kurse ato të fesë islame me shkronjë të vogël.

Fjalë nga fusha e bujqësisë: **barii- u**, *m.* – pastir, çobanin; **bahçe (lulishte) bahçe- ja**, *ž.* – vrt. bašča; **bereqet (-i), korre-a)**, *m.* – žetva; **arë-a**, *ž.* – njiva, polje; **buqaar- i; buqarë;** *m.* – ratar, seljak; **blue(me) va.** – mljeti, svariti, probaviti; **çoban- i, çobaj-t** *m.* – çoban, pastir; **drith-i; drithna** *m.* – pšenica, žito; **farë-a**, *ž.* – sjeme, vrsta, rod; faret- potpuno, posve; **fije- a**, *ž.* – konac; me vûn per fije – ured- no postaviti, rasporediti etj.

Leksik i mjekësisë: **baarë-i; barna, bare**, *m.* – bilje, kupus, lijek, medicina **barnaxhii-a (barnataar), barnataar-i**, *m.* – apotekar, ljekarnik; **ethe- t**, *ž.* – (bez singulara) – groznica; **heqim-i (mjek-u)**, *m.* – liječnik; **mjek-u**, *ë.m.* – liječnik, doktor etj., si edhe në fjalorin serbokroatisht-shqip: **apoteka**, *ž.* = barnehane- ja, *pl.* – barnehane-t, barnatore-ja; **apotekar**, *m.* – barnatarë-i, *pl.* barnatarë-t; barnaxhij-a, *pl.* – ii-t; **bilje (kupus, zelenje)** *n.m.* = barë-i, *pl.* barë-t, barna-t; **bolest**, *ž.* = dergjë-a, *pl.* dergjë-t; lëngatë-a, *pl.* lengata-t; **bolest**, *ž.* = smund-a, *pl.* smunda-t. etj.

Emra të mjeteve: **arkë- a**, *a ž.* – sanduk, kovčekg, škrinja; **armë- a**, *ž.* – oružje, puška; **baul-i**, *a.m.* – kofer, kovčeg, sanduk; **bisht e gyp-i**, *a, m.* – držalo(za pero); **brushë-a**, *ž.* – kefa, četka; **buljerë-a;** *a, ž.* – mala bačva za vodu; **burrot-i**, *m.* – burmut(za šmrkanje); **bisht-i; bishtna**, *m.* – rep, skut, varka; **çilc-i a**, *m.* – ključ; **çinii-a**, *ž.* – tanjur, pladanj, činija; **divit-i**, *a, m.* – tintarnica; **dràpen, drapni** *a,m.* – srp; **facoletë- a**, *ž.* – džepni rubac; **fyshek-u** *ë, m.* – naboj, fišek, patrona; **gotë-a** *a, ž.* – čaša(za piće); një gotë birrë- čaša piva; **gyp-i**, *m.* – cilindër, trska, cijev kamiš; **gjyle-ja**, *ž.* – željezna kugla, bomba; **kandil-i** *a, m.* – lampa, svijetlo; **karrigë-a** *a, ž.* – stolica; **tavolinë-a**, *ž.* – pisaći stol; **karrocë-a**, *a, ž.* – kočija, kola; **kir-i**, *m.* – kiri (bujica); **konop-i** *ë, m.* – uže, konop, jedek; **koos-a**, *ž.* – kosa, srp; **kumonë-a** *e, ž.* – zvono; **kutti- a** *a, ž.* – kutija, škatulja; **lugë-a** *e, ž.* – kašika, žlica; **llampë-a**, *a, ž.* – lampa, vjetiljka; **llullë-a** *a, ž.* – cijev, kamiš, lula; **parmak-u.ë, m. – mreža, rešetka; parmaci (ograda kao rešetka); **parmënsë-a**, *ž.* – ralo, plug, lemeš, raonik; **pàrzem, parzma**, *a, ž.* – prsa, njedra, dojke; **pëndë-a**, *a, ž.* – pero, gat, nasip; **tepsii-a**, *ž.* – tiganj, lončić, šerpa, tava, čanak, tendžera za tortu; **tas-i** *a, m.* – zdjela, zdjelica, plitica, fildžan; **ternagop-i**, *a,m.* – poluga, ćuskija, pralisa; **shtyllë-a** *a,ž.* – stup, oslon, poduporanj, štaka, uzdanica; **thikë-a** *a,ž.* – nož; **valigjë-a**, *ž.* – putna torba; **vângë-a**, *a,ž.* – motika, kopača, budak etj.**

Për shkak të ndonjë lëshimi tektnik, të korrekturës apo mosnjohjes autori e ka dalluar afrikaten **xh** dhe palatalen **gj**, te fjala **valigjë-a**, *ž.* – putna torba, ka përdorur palatalen **gj**, në vend të afrikates **xh**, ashtu siç edhe shkruhet dhe shqiptohet. Këtu kemi rrafshim mes këtyre dy bashkëtingëlloreve për shkak të mosdallimit të vendit të nyjetimit.

Fjalë që shënojnë pjesë të trupit/organizmit: **ashke-ja**, *ž.* – trijeska, luč, iver; **asht- i**; *pl.* eshtna, *m.* – kost; **bark-u**, *m.* – trbuh; **bisht-i; bishtna**, *m.* – rep, skut, varka; **dell-i**, **dej**, *m.* – žila, puls, bilo; **dorë-a, durë**, *ž.* – ruka; punë doret- ručni rad; **dham'i** *ë m.* – zub; **etedja**, *ž.* – žeda; m'kaa marrë edja- žedan sam; **faqe-ja**, *ž.* – lice, obraz, strana; face bardhë- časno lice; per faqe t'bardhë – vrlo dobro; per faqe t'zezë – vrlo loše; faqe-zii- nečastan čovjek; **flok-u** *e, m.* – kosa, vlas; **fyti** *a, m.* – vrat, grlo, grkljan; **gisht-i** *a,m.* – prst; një gisht leter- nekoliko redaka; **gojë- a; gojna**, *ž.* – usta, rilo, ušće; **gjak-u**; **gjaqe**, *m.* – krv; **hëndë-a**, *ž.* – nos; një hunde burrot- šrk, prstovet duhana (burmuta); **kamë-a**, *ž.* – noga, kost, stepen (ica); **krah-i**, *ë, m.* – rame, ruka, pasuh; me kapë per krahësh- grliti, zagrliti; **krahuer-nori**, *m.* – prsa njedra, krilo; **krye, kryyt, krena**, *m.* – glava; krye shtatë ditsh- poslije sedam dana; **krye, kren; kren**, *m.* – glavni, pretpostavljeni, glavno poglavlje (koje knjige); **lkurë-a** *a, ž.* – koža, skorup, povlaka, kora, krasta; **syy, syni**, *m.* – oko; **shtat-i**, *n.* – tijelo, stas, statura, snaga; **vesh- i**, *e,m.* – uho, sluh; **zëmer-a** *a,ž.* – srce; ćud etj. Po edhe **Čeljust, vilica**, *ž.* = fulqii-a, (felqii-a), *pl.* filqii-t; ndofullë-a, *pl.* ndofulla-t etj., te *Fjalori serbokroatisht-shqip*.

Stinët, muajt e vitit dhe ditët e javës: **prëndveer-a**, ž.- proljeće; **veer-a**, ž.- ljeto; veers-ljeti; **vjeshtë-a** a,ž.- jesen, podzimak; **dimen, dimni**, m. – zima; **fruer, frori**, m.- februar, xeljača; **maj-i**, m. – maj (mjeseć); **marc-i**, m. – mart (mjeseć); **priill-i**, m. – april (mjeseć); **qershuer-shori**, m.- juni(mjeseć); **dile-ja (e)**, ž. – nedjelja; **ëjte-ja**, ž. – četvrtak; **hâne-ja (e)**, ž. – ponedjeljak; **marte-ja (e)** utorak; **merkurre-ja(e)**, ž.- srijeda; **shtunde-ja(e)**, ž.- subota etj.

Leksik që shënon emërtime të ushqimit, pijeve, pemëve dhe perimeve: **amelcim-i**, – slatkoća, slatkiš, poslastica (m); **amelcinë-a**, ž.- Konfekt, kolač, poslastica, slatko voce; **bukë-a**, ž. – kruh, hljeb; **djathë- i** ; **djathna**, m. – sir; **grosh-i a**, m. – groš(novac u vrijednosti od oko 20 helera (para); **hae-ja**; **haena**, ž. – jelo, hrana, jestivo; **harxh-i e**, m. – potreba, trošak, zaliha, pričuva, prištednja; me blee harxhe- prištediti; **krypë- a**; **krypna**, ž. – sol; **laken-kna a**, ž. – kupus, kelj, zelje; **lang-u**, m. – juha, čorba, supa; **mazë-a**, ž.- kajmak, skorup, čad; **sheqer-i**; **sheqerna**, m.- šećer, slador; **ufull a**, ž.- ocat, sirće; **voe, voeja**; **voe**, ž.- jaje; **voj, voji:vojna**, m.- ulje, zejtin; voj gurit- petroleum, gas; **birrë-a**, ž.- pivo; **kafë-ja**, ž.- kafa, kava; **rakii-a**, ž.- rakija, šnaps; **tàmel-i**, m.- mlijeko; **uj, ûji; ùjna**, m.- voda, more, rijeka, sjaj, mokrača; **vënë-a**, ž.- vino, loza; **ardhii- a**, ž. – trs. Čokot, vinova loza; **arrë-a a**, ž. – orah; **čajre-ja**, ž.- sredstvo, lijek; **dranofille-ja**, ž.- ruža, ružica; **drûu, drûni; drûn**, m. – drvo, šuma, stablo, građa; **duhan-i**, m. – duhan, duvan; me pii duhan- pušiti; **gardh-i, gardhiqe**, m. – plot, ograda, živica, grm; **gem-i**, a,m.- grana, grančica, mladica; **grun-i**, m. – zrno, pšenica; **gjeth-i**, Ë, m. – list, lišće; **huder, hudra**, a ž. – češnjak, bijeli luk; **lis-i a,m** . –drvo, stablo, hrast; **lule-ja**, ž. – cvijet, cvijeće; **mollë-a a**, ž.- jabuka; **qepë- a a**, ž.- luk crveni, crljenac, lukovica; **qershii-a a**, ž.- trešnja; **thanë-a a,ž**- drijen, drenjina; **ullii-ni; ullî**, m.- maslina, oliva etj. Po kështu mund të theksojmë dosa fjalë te *Fjalori serbokroatisht-shqip*: **breskva**, ž.= pjeshkë-a , pl. pjeshka-t; **burmut**, m.= burrnot-i; **Çempres(cypresa)**, m. = qyparis-i, pl. qyparisa-t etj.

Fjalë që shënojnë kafshë dhe insekte dhe shpezë: **bletë-a** Ë, a, ž. – pčela; **breshkë-a**, a, ž.- kornjača, željva; **bylbyl-i a**, m. – slavuj; **dallnyshë-a**, a ž. – lastavica; **dash-i** ; **desh**, m. – ovan **dele- ja** ž.- ovca, bravče; **dhèlpen, dhèlpna a**, ž. – lisica, riđan(konj); **dhii-a**, ž.- koza; **flùter, flutra**, a, ž. – leptir; **gjâa-ja** ž. – stvar, okolnost, činjenuca, tvar , imanje; s’đii gjâa-ja ništa ne znam; **gjarpen- pni; gjarpi**, m. – zmija, guja; **kaa, kau** ; **qee**, m. – vo, bik; **kaal, kali** ; **kual**, m. – konj; **lèpur-i a**, m. – zec; **lopë-a** , ž.- krava; **luâa-ni; luâj**, m. – lav; **micë-a**, ž. – mačka; **njalë-a a**, ž.- jegulja; **peshk-i; peshq**, m. – riba; **plesht-i a**, m. – buha; **troftë-a**, a,ž.- forela(riba), pastrva; **trumcak-u**, Ë,m- vrabac, vrebac; **tùrtull-i; turtuj**, ž.- grlica; **thii-u**, m.- svinja, prašćić, odojak; **ujk-u (uk-u)** ; **uq**, m.- vuk, kurjak, vućac(oderina među kracima); **viç-i a,m** – tele; **zog/u** ; **zogj**, m.- ptica etj., po edhe te *Fjalori serbokroatisht-shqip*: **janješce**, n.= bec-i, pl. beca-t, kîi kîji; kija; **kokoš**, ž.= pulë-a, pl. pula-t; - **zogë-a**, pl. zoga-t; **komarac(mušica)** , m.= mushkajë-a, pl. mushkaja-t; **lisica(i konj riđan)**, ž.m.= dhèlpen- dhèlpna, pl. dhèlpna-t; skile-skilja, pl. skile-t etj.

Fjalë që shënojnë përkatësi: **burrë-i** , - a, m. – muž, čovjek; **djalë-i m, djelm, djel**, m. – mladić, dječak, dijete; **djalog- i a**, m. – mladić; **fmii-a**, m. –dijete, dječak, daran; **grue-ja** ; **graa**, ž. – žena, supruga; **gjind-ja**, ž. – ljudi, čeljad, posluga; **hallk-u(popull-i)** , m. – puk, narod, čeljad; **jetim-i**, m. – siročë, jetim; **katundare-ja**, ž.- seljanka; **katundar-i** , **katundare**, m. – seljak; **plak-u, pleq**, m. –stari, starac; **shok-u** Ë,m.- drug, drugar, kalfa; **shoqe-ja**, ž.- drugarica; e shoqja-žena, supruga; **shoq-i; shokë**, m.- drugar, bližnji; i shoqi- muž, suprug; **shoqi shoqjn**, adv.- uzajamno; **vajzë-a, varza**, ž.- djevojka, djeva, moma; **Zojë-a** ž.- Preblažena Djevica Marija, Majka Požja etj.

Fjalë që emërtojnë veshje dhe tekstile: **bernavekë-t**, m. – široke skadarske hlaće; **çarap-i**, Ë,m. – čarapa, bječva; **degermii-a** , ž. – bijela koprena, veo; **fes-i a**, m. – fes (turska kapa); **gjurdii-a** , ž.- košulja, prsluk, premetača, dolama, zobun; **kmishë- a a**, ž.- košulha; **kunder, kundra a**, ž. – čizma, visoka cipela, cipela; **pantalona- t**, m. – hlaće, pantalone; **petk-u a**, m. – odijelo,/ancug/; **sèter, setra**, a,m.- kabanica, kaput, sgrtač, plašt; **tlina-t**, ž.- gaće,

gaćice; **veshë-a** *a, ž.* – odijelo, približavanje, ruho, oprava, odora; **lesh-i**, **leshna**, *m.* – vuna (dlaka, pamuk); **cohë-a** *ž.* – Sukno, coha; **çarçaf-i** *a, m.* – plahta, çarşaf; **pelhurë-a** *ž.* – platno, bez, postava; me bâa pelhurë- tkati, plesti; **perde-ja (kupe-ja)**, *ž.* – veo, koprena, po krivalo, ruho etj. Gjithashtu identifikojmë fjalët **Çarapa**, **bjeçva**, **podkoljenica**, *ž.* = çarap-i, *pl.* çarape-t; kamcë-a, kamcë-t; kallmë-a, *pl.* kallma-t.; **cipele (obuça, kundure)** *ž.* = kpuçë-i, *pl.* kpuçë-t; obuti, navući cipele= me i vûu kpuçët. Te kjo fjalë, autori numrin njëjës e ka përdorur në gjininë mashkullore, me mbaresën i, pavarësisht se në numrin shumës e ka përdorur në gjininë femërore, mirëpo në shqipen si për njëjës ashtu edhe për shumës përdoret në gjininë femërore. Këpuçë-a; këpuçë-t.

Fjalë që emërtojnë profesione dhe institucione: drrasaxhii-a *m.* – stolar; **dugajxhii-a**, *m.* – trgovčić, kramar; **dugajë- a**, *ž.* – dućan, krillo, kapak, daščara, dućančić; **gjuetaar-i** *e, m.* – lovac; **gjojë- a**, *ž.* – lov; **gju(e)** – loviti, pogoditi; me gjue n'gurë- zasuti kamenjem, kamenovati; **hamall-i; hamaj**, *m.* – nosaç, hamal; **hysmeqaar-i (rroqtaar- i)**; **hysmeqarë**, *m.* – sluga, izmeçar; **hysmeqare-ja (rroqtare-ja)**, *ž.* – izmeçarka, sluškinja; **kamarjer-i**, *m.* – komornik; **karrocaxhii-a**, *m.* – kočijaš, kolar; **kndimi**, *e, m.* – studij, lektira, çitanje, učenje; **kundraxhii-a**, *m.* – cipelar, obuçar, kundurdžija; **lundraxhii-a (lundertaar-i)**, *m.* – lada(crkve), ponutrica; **nallban-i** *a,m.-* potkivač; **simitçii-a**, *m.-* pekar(hljeba); **shkollaar-i; shkollarë**, *m.-* učenik, đak, školar; **mjështer, mjeshttra** *a, ž.* – učiteljica; **mjështer, mjeshtri** *a, m.* – učitelj; **kollegjë-a** *a, ž.* – koledž. kolegijum; **kuvend-i** *e, m.* – skupština, razgovor, pregovori; **shkollë-a** *a, ž.* – škola etj.

Sikur mund të vihet re në këtë kategori fjalësh, te fjala **mjështer, mjeshttra**, e gjinisë femërore, ka ndjekur analogjinë e mbaresës që marrin emrat e gjinisë femërore, mbaresën **a**, por në shqipen disa emra marrin mbaresën **e**, siç është edhe shembulli **mjeshtre**.

Fjalë që emërtojnë tituj shtetëror, ushtarak: kralj-i *a, m.* – kralj; **mret-i, mretna**, *m.* – kralj, car, sulltan; **pashë-a, pashallarë**, *m.* – paša; **kufitaar** *e, adj.* – susjedno. Pogranično; **kaushe- a, ž** – kasarna, vojarna; **luftë-a** *a,ž.* – boj, rat, bitka; **ushtar-i; ushtarë**, *m.-* ratnik, borac etj. Gjithashtu edhe te *Fjalori serbokroatisht-shqip: kapetan*, *m.* = kapidan-i, *pl.* kapidana-t; priis- prisi, *pl.* priisa-t. Në kërkim të veçorive gramatikore të *Fjalorit të vogël shqip-serbokroataisht*, janë me interes të kërkimit të disa aspekteve morfologjike dhe mënyrës se si janë shënuar apo identifikuar disa fjalë, trajta dhe struktura morfologjike të tyre, duek parë madje edhe ndonjë lëshim a specifitkim të tyre.

Në plan të parë duam të identifikojmë disa nga **ndajfoljet: afer**, *adv.* – blizu, u blizini; **alaa**, (endë), *adv.* – još; **andej**, *adv.* – prijeko, s one strane; **aspak**, *adv.* – sasvim ništa; **ashtu**, *adv.* – tako, na taj način; **aq**, *adv.* – kako jako, tako jako; **atbotë**, *adv.* – tada, u ono vrijeme; **atjè**, *adv.* – tamo, ondje, tu; **aty**, *adv.-* tamo; atypari- pored, pokraj, uz; **barabar(gjithnji)**, *adv.* – također, isto tako, jednako; **barè (nemosè)**, *adv.* – barem, u najmanju ruku; **bashkë, s'bashkut** *adv.* – skupa. Zajedno; **beldà (ndoshta)**, *adv.* – možda, valjda; **boll, (mjefit)** *adv.* – dosta; **dikuer**, *adv.* – nekoć, nekad; **disi**, *adv.* – nekako, na neki način; **dje** *adv.* – jučer; **domosdò**, *adv.* – pod svaku cijenu, apsolutno; **endè**. *adv.* – još; s'kaa ardhë endè – zar on još nije došao?; **fort**, *adv.* – mnogo, jako; **franka (a la franka)** – *adv.* – na evropski način, po evropskom običaju; **gadi**, *adv.* – gotovo, skoro; **gadi**, *adv.* (indekl.) – gotovo, spreman; - me kënë gadi- biti spreman; me bâa gadi- zgotoviti, svršiti; **giat**, *adv.* – dugo; giat e giat- vrlo dugo; **gjitmonë**, *adv.* – uvijek, u svako doba; **gjitshajt**, *adv.* – usvemu, sveukupno; **njinji**, *adv.-* na isti način, također; **tesh** *adv.-* sada; tesh per tesh- z asada; **tek**, *adv.-* gle, eto! ; tek jam- tu sam ja- praep. pri, pokraj; **tash**, *adv.-* sada; tash per tash- z asada, za ovaj čas, momena; **shtrëjt**, *adv.* – skup (o cijeni); **thue(a)?**, *adv.-* možda, valjda?; **veç**, *adv.-* sam. Jedini; veç se-osim toga; **vetem, vetun**, *adv.-* samo, jedino; **vonë**, *adv.-* kasno; tash vonë- najposlije, napokon, na kraju; **vorfnisht**, *adv.-* bijedno, jadno, siromašno; **vrap**, *adv.-* skokom, u propanj, jašući uzpropnice, u galop; **zakonisht**, *adv.-* po navici, po običaju, po zakonu; **palè**, *adv.* – možde, moguće; **po**, *adv.* – da; **ktheell**, *adv.* – temeljito, duboko; **madjè**, *adv.* – prije, rađe, obratno, naprotiv etj.

Te ndajfoljet, vlen të përmendet ndajfolja **giat**, ku në aspektin fonetik, autori për shkaqe mosshqiptimi të bashkëtingëllores **gj- gjat**, e ka shënuar zanoren **i**. Gjithashtu, te fjala **pale**, e cila në kontekstin që e ka përdorur autori, në shqipen është **pjesëz**, mirëpo ai e kategorizon te ndajfoljet. Po kështu ndodh edhe me fjalën **madjë**, që në shqipen është **pjesëz**, autori e shënon si ndajfolje. Te ndajfolja **ktheell**, e shënon me bashkëtingëlloren **k** para, por që në shqipen si atë dialektore si atë standarde, shqiptohet si **thellë** ose **fell**.

Lë të theksojmë këtu edhe disa mbiemra dhe veçori të identifikimit dhe tipologjisë së tyre: **adjektiv-i**, *a, m.* – pridjev, adjektiv; **amel (i-e)**, *adj.* – sladak, mek, nježan; **bardhë(i, e)**, *adj.* – bijel, (metafor.) veledušan, jednako; **bukur (i, e)**, *adj.* – lijep, pristao; **diishem (i, e)** *adj.* – učen, književni; **do** *adj(indekl.)* – nešto, malo- do bukë- malo hljeba; do djathë- malo sira; **dytë-i (i)** *adj.* – drugi; **dytë- a (e)**, *adj.* – druga; **ingliz-e**, *adj.* – engleski; **italjan-e**, *adj.* – italijanski; **shqyp-e**, *adj.*- albanski, šiptarski; **fatbardhë (i,e)** *adj.*- blagoslovljen, sretan; **foort(i,e)** *adj.* – jak, tvrd, čvrst; **fresktë(i, e)** *adj.* – frižak, svjež, hladan; **giatë (i, e)** *adj.* – dugačak, dugo; per giatë mot- kroz dugo vremena; **gjallë(i,e)** *adj.* – živ; saa t’jemi gjallë- dok ja živim; **katert (i, e)** *adj.* – četvrti; **rii (i, e)** *adj.* – mlad, nov, mladenački; **tânë (t’)**, *adj.*- svi; t’âna- sve; **shum**, *adj.*- mnogo, puno, jako; **shum**, *adj. (indekl.)* – mnogi; **shumi(i)**, *adj.*- siromašan, bijedan; **udobtë(i,e)** *adj.* – običan, navadan, lak, lagan; **ultë(i,e)** *adj.* – nizak, podal, dubok, nalen, sitan; **unshem e(i,e)** *adj.*- gladan; **urtë(i,e)** *adj.* – pametan, mudar, razborit, čedan, skroman, pristojan; **verbtë(i, e)**, *adj.*- slijep; **vöcerr(i,e)**, *adj.*- malen, sitan; **vögel(i,e)**, *adj.*- malen, nizak, niska, rasta; **vörfen(i,e)** *adj.*- bijedan, ubig, siromašan; **xeet(i,e)** *adj.* – vruć, topao; **zii(i)**, **zezë(e)**, *adj.*- crn, zao, zločest; **zoorshem-e (i,e)** *adj.*- težak, tegoban; **zoti (i)**, *adj.*- m.- sposoban, pristao vješt, okretan; I zot i shpiis- domaćin, kućevlasnik, gospodar; **zoja (e)**, *adj.*- ž.a sposobna, pristala, vješta, okretna, ; e zoja e shpis – domaćica, kućevlasnica, gospodarica etj.

Te kategorija e mbiemrave, përveç atyre që i kam kategorizuar si më poshtë, janë edhe disa që i ka trajtuar si mbiemra mirëpo gramatikisht nuk janë të tillë, p.sh. **do** *adj(indekl.)* – nešto, malo- do bukë- malo hljeba; do djathë- malo sira, e ka trajtuar si pjesëz, por edhe si mbiemër, mirëpo përveçse si **pjesëz**, fjala **do**, përdoret edhe si **përemër i pacaktuar**, e jo si **mbiemër**. Një fjalë tjetër të cilën autori e ka përdorur si mbiemër është edhe fjala **fatbardhë (i,e)** *adj.*- blagoslovljen, sretan, e cila është e tillë, pra **mbiemër**, mirëpo në shqipen hyn te **mbiemrat e panyjshëm**, e që në këtë rast autori ka ndjekur analogjinë duke i shtuar nyjet përpara.

Diskutime mund të bëhen edhe për numërorët dhe përemrat. Le të identifikojmë fillimisht disa **numërorë**: **reqind**, *adj.*- tri stotnine, tristo; **trii**, *adj.(f)*- tri; **tridhetë**, *adj.* – trideset; **shtatë**, *adj.*- sedam; **tre**, *adj.(m)*- tri; **tetë**,*adj.*- osam(broj); **ndândë**, *adj.* – devet; **ndânddhet**, *adj.* – devedeset; **ndândqind**, *adj.* – devet stotina; **kater**, *adj.* – çetiri; **katerdhetë**, *adj.* – çetrdret; **katermdhetë**, *adj.* – çetnaest; **katerqind**, *adj.* – çetiri stotine; **‘izet(njizet)**, *adj.* – dvadeset; **dy**, *adj.* – dva (muški); **dymdhet**, *adj.* – dvanaest; **dyy**, *adj.* - dvije (ženski); **dhet gjashtë** *adj.* – šest; **gjashtdhet** *adj.* – šezdeset; **gjashtmdhet** *adj.* – šesnaest; **dhetë** *adj.* – deset etj.

Të gjithë këta **numërorë**, të cilët edhe i kam kategorizuar si të tillë, autori i ka shënuar si **mbiemra**, por që në shqipen, nuk hyjnë te kjo pjesë e ligjëratës, por tek ajo e **numërorit**. Të kësaj natyre janë edhe një numër përemrash: **aj**, *pron.* – on, onaj, ono; **ajò**, *pron.* – ona; **askush**, *pron.* – nitko; **asnji**, *pron.* – nijedan, nijedna, nijedno; **atà**, *pron.* – oni, one; **atò**, *pron.* – oni. one; **cilla?** *z. pron.* – koja?; **cilla?** *z. pron.rel.* – koja; **cilli?** *m. pron.* – koji?; **cilli?** *(i) m.pron.rel.* – koji; **ç**, *pron.* - šta, koji; ç’at ditë – od ono – ga dana; **ça**, *pron.* – šta; **çka** *pron.* – šta; **diçka (indekl.)** *pron.*- nešto; **dikush**, *pron.* – netko, itko; **disaa**, *adj. (indekl.)* – nekoliko; **dishka (indekl.)**, *pron.* – ma štogod, išta, ikoliko; **e**, *conjunct. i, - pron.* – njega, nju, ono; **gjithçka**, *pron.* – (indekl.) – sve; **gjithkush**, *pron.* – svaki pojedini; **ju**, *pron.* – vi; **ti**, *pron.*- ti; **un(une)** *pron.*- ja; **vedi**, *pron.*- se, sebe samog; ne vedi- samnom sa tobom, sa sobom; **vetë**, *pron.*- ja, ja sam; ti, ti sam; on, on sam, ona, ona sama, i t.d; **ndoj (ndonji)**, *adj.* – ikoji; **tuu(t’**,

adj.) – tvoja (na pr. Braća); **ynë(i)** *adj.*- naš; **vet(i, e)** , *adj.*- njegov, njezin, njegovo; **jone (i, e)** *adj.* – naš; **jotë(e)**, *adj.* – tvoja; **Ēm-i (i)** *adj.* – mene (meiner); **Ēm-e (e)** *adj.* – mene (meine); **gjith(t’)** , *adj.* – čitavo, sve (m.); **gjitha (t’)**, *adj.* – čitavo, sve (ž.); **gjithesecilla**, *adj.* – svaka pojedina; **gjithicilli**, *adj.* – svaki pojedini etj.

Përemrat, janë kategoria në të cilën gjithashtu, autori, disa prej tyre i ka shënjuar si mbiemra, mirëpo edhe këta nuk janë të tillë, këtu përfshihen disa nga *përemrat e pacaktuar* dhe *përemrat pronorë*. Le të sjellim gjithashtu edhe disa shembuj të strukturave gjuhësore në gjuhën serbokroate nga fjalorthi i dytë *serbokroatisht-shqip*, duke i rimarrë ato krahas komenteve të caktuara.

Njësitë leksikore të kategorizuara si emra: blagdan (svetkovina) *m.* ž.= festë-a, *pl.*- festa-t; kreme-ja, *e-t*; **(boj) kat, sprat**, *m.*= pat-pati, *pl.* pata-t; **cesta(ulica, drum)** , *ž.m.* = rrugë-rruga, *pl.* rrugë-t; glavna cesta= drom-i, drome-t; xhade- xhadja, *pl.* zhade-t; **ceremonija**, *ž.* = sjellë-a, *pl.* sjella-t; **cigara**, *ž.* = cigarë-i, *pl.* cigare-t; cingare-ja, *pl.* cingare-t; **cisterna(bunar)** , *ž.*= bunarë-i, *pl.*bunarë-t; saranxhe-ja, *pl.* saranxhe-t; hurdhë-a, *pl.* hurdha-t; **civilizacija**, *ž.* = qytetnimi, *e-t*; **dječak**, *m.*= dialë-i, *pl.* dielm-t, diel-t; **djevojka**, *ž.*= vajzë-a, *pl.* varza-t; **domovina, otačbina**, *ž.*= atëdhe-u , *pl.* atëdhena-t, atëme-ja, *pl.* atëme-t; **ideja(pojam, fiksna misao)** *ž.*= meer-a, *pl.* meera-t; shllim-i, *pl.* shllime-t; **interes, zanimljivost(kamate)** , *m.ž.*= levertii-a, *pl.* levertina-t; interese-a, *pl.* a-t; murad-i, *pl.* murade-t; **iskustvo(praksa, vježbanje)** *n.ž.*= zâje-zâja, *pl.* zâje-t; **jezik (govor, riječ, glas)** , *m.* *ž.*= giuhë-a, *pl.* giuhë-t; obuzdati jezik= me ndalë giuhen; **jugoistočni vjetar**, *m.*= shirok-u, *pl.* shiroqe-t; notii-notia, *pl.*notii-t; **jutro (istok)** , *n. m.* = nadje-a, *pl.* nadje-t; - ovog jutra= sot nadje; **livadarstvo**, *n.*= fushe-a, *pl.* fusha-t, fushore-ja, *pl.* fushore-t; **mladić (momak)** , *m.*= djalë- djali, *pl.* djelm-t; djaloç- djaloçi, *pl.* djaloça-t; **način, (navika, običaj)** , *m.*= mndyrë-a, mndyrë-t; **pobjednik**, *m.*= mujtarë-i, *pl.* mujtarë-t; fitues-i, *pl.* fituesa-t; **sunce**, *m.*= diill-i, *pl.* diilla-t; **Šteta**, *ž.*= qeder-i, *pl.* qedërë-t; **Šuma**, *š.*= pyllë-a, pyll-i, *pl.* pylla-t; **torba (kožna)- putna torba**, *ž.*= valigjë-a, *pl.* valigja-t, çantë-a; **kćerka, jedinica**= dhelatorë-ja; **kosa (vlas)**, *ž.m.* = flok-u, *pl.* flokë-t; krip-i, *pl.* kripa-t; **namještaj, pokušstvo**, *m. n.*= takam- takami, *pl.* takame-t; rraqe-ja, *pl.* rraqe-t etj.

Te kategoria e emrave, fjala **(boj) kat, sprat**, *m.*= pat-pati, *pl.* pata-t, në gjuhën kroate e jep kuptimin për; kat,-i emër i gjinisë mashkullore; numri shumë; -e(t) 1. hapësira a pjesa e një ndërtese, që ngrihet mbi një tjetër me të njëjtën lartësi: kati i parë (përdhes); pallat me pesë kate, por fjala që e përdorë në shqipen pat-pati, pata-t, nuk përputhet kuptimisht me atë që shënon në kroatisht. Te emri **civilizacija**, *ž.* = qytetnimi, *e-t*, përdorë palatalen **q**, ku vërehet një inconsistency përdorimi, për shkak se në disa vende e ka përdorur palatalen **gj**.

Njësinë **ceremonija**, *ž.* = sjellë-a, *pl.* sjella-t, kjo fjalë ndoshta është përdorur në ndonjë trajtë dialektore ose autori është munduar ta përshtatë në kontekst sipas kuptimit të dytë që jepet në fjalorin e gjuhës shqipe, për fjalën *ceremoni*; ceremoní,-a emër i gjinisë femërore; numri shumë; -(të) 1. veprimtari për të kremtuar a për të përkujtuar një ngjarje të shënuar; festim, kremtim: ceremoni zyrtare (solemne, fetare); ceremonia e martesës (e varrimit, e pagëzimit). 2. *kryesisht*; numri shumë; -ra(t) i ligjërimit bisedor; *mënyrë e stërholluar e sjelljes me etiketë të trëuar: pa shumë ceremonira*.

Njësinë leksikore **dječak**, *m.* e ka kategorizuar si dialë-i, *pl.* dielm-t, diel-t; ndërsa njësinë tjetër **mladić (momak)** , *m.* e ka kategorizuar si djalë- djali, *pl.* djelm-t; djaloç- djaloçi, *pl.* djaloça-t. Te këto dy fjalë, pavarësisht se i përdorë në kontekste të ndryshme, forma fonemore e përdorimit të tyre në shqipen është e njëjtë, dhe vërehet se autori është munduar t’i dallojë në bazë të një foneme- duke përdorur për kuptimin e parë zanoren *i*; *djalë- djalë i vogël, në moshë të re, çun*, kurse për atë të dytin bashkëtingëlloren *j- djalë- djalë i ri, më i rritur*.

Le të sjellim edhe disa shembuj: për fjalën **iskustvo(praksa, vježbanje)** *n.ž.*= zâje-zâja, *pl.* zâje-t, në kuptimin që e ka dhënë për këto fjalë në gjuhën serbo-kroate, pra për përvojën ose eksperiencën, kuptimi që autori e jep për fjalën shqipe, përveç nëse është përdorur në ndonjë trajtë dialektore, nuk përputhet, për shkak se në shqipen fjala zâje ka këtë kuptim; za/ll,-lli emër

i gjinisë mashkullore; numri shumës; *-je(t)*: gur i vogël e i *lëmuar* në shtratin e një lumi; gurë të vegjël dhe rërë që sjell me vete një lumë, *\zallishtë*; numri shumës; *-lle(t)*: *bregu* i detit, i lumit a i liqenit me gurë të tillë: gur zalli; zallet e Shqipërisë. Duke u bazuar në këtë, e vetmja ngatërresë që mund të jetë bërë, është me fjalën; *Zëj/e*, -a emër i gjinisë femërore; numri shumës; *-e(t)* mjeshtëri, *zanat*: zejet popullore; zeja e këpucarit (e furrtarit), që kontekstualisht do të përshtatej më shumë me fjalën që e jep autori në gjuhën serbo-kroate.

- **pobjednik**, *m.*= mujtare-i, *pl.* mujtare-t; fitues-i, *pl.* fituesa-t, një fjalë që në shqipen e sotme nuk haset të përdoret më, është fjalë shumë e veçantë, që përdorej në shqipen për fituesin.

- **sunce**, *m.*= diill-i, *pl.* diilla-t, në numrin shumës këtë fjalë ndoshta e ka përdorur duke ndjekur analogjinë e formimit të shumësit të disa emrave mashkullorë në trajtat dialektore, dhe që të shërbejë në përdorim letrar ose për ndonjë kontekst të caktuar pasi edhe në fjalorin e gjuhës shqipe, nuk jepet shumësi i tij.

- **kčerka, jedinica**= dhelatorë-ja, në kuptimin e vajzës së vetme apo bijës së vetme, dhelatorë-ja, mund të jetë përdorur në kontekstin si vajzë e ledhatuar.

- **kosa (vlas)**, *ž.m.* = flok-u, *pl.* flokë-t; krip-i, *pl.* kripa-t. Kosa dhe vlas, në serbo-kroatisht kanë kuptimin e flokut, mirëpo pse autori ka shënuar edhe fjalën krip-i, kripa-t, që në shqipen nuk e kam hasur në asnjë kontekst të shënojë flokun apo diçka që lidhet me flokët.

Edhe mbiemrat janë disa prej shembujve të cilët mendojmë se janë të identifikohen në trajtimin tonë: **dug, dugačak**, *adj.* = (i,e) giatë; na dugo vrijeme= per giatë mot; giatë e giatë; **gladak, ravan, prost, prav**, *adj.* (i,e)= fjeshtë, (i,e) çilet, (i,e), paa t'keq, (i,e) paperziim-e; **glasan, glasovit**, *adj.*= (i,e) n'zâa; ne govori glasno= mos fol me zâa t'neltë; **moj**, *adj.* – i, em, e eme, ; t' mii, t' mia; **nepristojan, neuljudan**, *adj.* (i, e) = panierziishem-e.

Në këtë kategori vërejmë përdorimin e një trajte dialektore, **dug, dugačak**, *adj.* = (i,e) giatë; na dugo vrijeme= per giatë mot; giatë e giatë, për shkak se dihet se në shqipen ka disa mënyra të përdorimit të mbiemrit **(i,e) gjatë, (i,e) gatë**, dhe një ndër to është edhe ajo që ka përdorur autori **(i,e) giatë**, që duket të jetë e të folmes së Shkodrës- shkodranishtes, duke u bazuar edhe në tiparet tjera të gegërishtes, të cilat hetohen në këtë dorëshkrim.

Përsëri, edhe këtu vërehet mungesa e bashkëtingëllores **th**, te fjala (i,e)= fjeshtë, për mbiemrin (i,e) thjeshtë. Te fjala, **glasan, glasovit**, *adj.*= (i,e) n'zâa; ne govori glasno= mos fol me zâa t'neltë., të cilën e ka trajtuar si mbiemër, (i,e) n'zâa, siç e ka përdorur autori, duket të jetë gramatikisht jokorrekte, për shkak se n'zâa, pavarësisht se mund të përdoret për të treguar tipare apo veti të një personi/ash, p.sh *ish n'zâa, ishin n'zâa*, nuk merr nyje përpara.

Megjithëse një shembull i vetëm, ja vlen të theksojmë numërorin **Četrdeset**, *num.*= katerdhetë; četrdeseti(i,e) = katerdhetë. Është një nga numërorët e pakët në këtë fjalor, që kategorizohet si numëror e jo si mbiemër. Në interes të hulumtimit tonë në këtë dorëshkrim, kujtojmë se janë edhe hulumtimi i pranisë së foljeve dhe diskutimi i shkurtër i tyre: Folja **biti**, *vn.* – me kenë; **brbljati, blebetati**, *vn.*= me çaa llafë, me çaa kopalla; me llaptue, me vertlue, me thye adra, me bâa zâa; **Čistiti (biti prekoren)**, *va.*= me dliir, me qirue, me shîi; čistiti cipele= me i shîi kundrat; **bacati**, *va.*- me qitë, me hjedhë; odbaciti, izgubiti= me tretë; **doći**, *vn.* = me ardhë, me raa; kada dolazi svetkovina sv. Nikole? Kuer bje festa e shen Kollit?; **grijati**, *vn.*= me xee; urgijati se na suncu= me zhegitë; **poludjeti**, *vn.*= me dalë meç; me irmue, me jermue, me raa n' kllapii; **skinuti s konja, sjašiti** = me zdrypë prej kalit; **tješiti se**, *va.*= me ngushllue, me zemrue.

Folja **biti**, *vn.* – me kenë, trajtë dialektore, të cilën e hasim edhe në të folme të tjera, si në formën: **m'u kanë, me qenë**, etj. Gjithashtu te te folja **tješiti se**, *va.*= me ngushllue, me zemrue, autori e ka përdorur në kuptimin *ngushëlloj* dikë, mirëpo në fjalën e dytë **me zemrue**, nuk e ka përcaktuar nëse e ka përdorur në kontekstin antonimik; ta zemërosh dikë d.m.th. të kundërtën e të ngushëlluarit, apo e ka përdorur si çift sinonimik *me zemrue- t'i japësh zemër dikujt, m'i dhanë zemër*, me kuptim konotativ, *ta ngushëllosh*.

Krahas foljeve, brenda fjalorthit zënë vend edhe ndajfoljet: **drugaçije(inače)**, *adv.* = ndryshej, tjetras, tjetërsi; **kada**, *adv.* = kuer (sa konjuktivom); - kuer t'shkojsh n' shkollë, kee me xânë; **navijeke**= per gjithmone, gjitherë, per herë; **sav**, *adj.* = gjith (t'gjith), t' tanë; sve= gjithshça, gjith mare etj. Në këtë kategori, vërejmë edhe pengesën që i ka shkaktuar mungesa e bashkëtingëllores **th** në alfabetin kroat, për shkak se nuk e shënon fare te shembujt **gjitherë (gjithherë)** dhe **gjithshça (gjithçka)**, te shembulli i dytë vërehet në masë më të madhe tendeca për ta paraqitur bashkëtingëlloren **th**, për shkak se i përdorë dy bashkëtingëlloret **sh** dhe **ç** në të njëjtën fjalë, për shkak se duke u munduar ta shqiptojë fjalën si të tillë e paraqet me këto dy fonema.

Në pasurinë leksikore, gramatikore, dialektore dhe semantike që sjellin këta dy fjalorë mund të diskutohen edhe disa njësi të cilat kanë edhe vlera sinonimike, si: **blato (nečist, govno, balaga)**, *nž.*- baltë-a, pl.- balta; llom-i, pl. llome-t; lloç-i, pl.- lloçe-t; **bliz (blizak, susjedan)** *adj.* (i, e) = aferm, afershem-shme; (i. e.), = ngiatë, kufitarë-e; **bogat(obilan)**, *adj.* (i,e) – zenjin-e, (i,e), pasun, (i,e) fjaashem-e, (i,e) begatshem-e; **bravo!**= t'lumt!; - per faqe t'bardhë; aferim!, etj.

Përfundime

Emanuel Krajinović (1891-1981) është një nga personalitetet e shquara të jetës politike, intelektuale dhe fetare të botës kroate, por njëkohësisht edhe njëri prej personaliteteve të shquara me kontribute të veçanta për Kosovën, çështjen politike dhe perspektive të saj. Autori i këtyre dy dorëshkrimeve leksikografike *Fjalor i vogël shqip-serbokroatisht* dhe *Fjalor i vogël kroatoserbisht –shqip* (Origjinal: “Mali rječnik albansko-srpskohervatski” dhe “Mali rječnik hervatskosrpski albanski”), nuk mund të themi se ka dhënë ndenje kontribut të madh në fushë të leksikografisë, e megjithatë do të mbahet mend për pasurinë dialektore të tyre dhe dashamirësinë e përgatitjes së tyre në një situatë shumë të errët në jetën shkencore, kulturore dhe kombëtare të popullit shqiptar nën Jusosllavi.

Sikur mund të shihet këtë fjalor e mbizotërojnë fjalë e shprehje kryesisht të jetës së zakonshme, të përditshmërisë, fjalë nga fusha të ndryshme si: bujqësia, emërtimet e kafshëve e të bimëve, ushqimeve, veshjeve, fjalët e aspektit fetar apo shpirtëror, emërtime për mjete të ndryshme, vende, profesione, etj., të cilat do t'i kenë shërbyer mjaft mirë për një komunikim të përditshëm. Ajo që vërejmë te *Fjalorthët* e Emanuel Krajinoviçit është gjithashtu edhe shënjimi i hundorësisë dhe i zanoreve të gjata. Dr. Emanuel Krajinoviç, vërehet se ka përdorur trajta të ndryshme dialektore, duke pasur parasysh se në kohën kur ai ka qëndruar në Kosovë, ende nuk kishte ndodhur standardizimi i gjuhës shqipe, andaj edhe vërehet një përdorim i larmishëm i trajtave të të folmeve të shqipes jo vetëm të Kosovës, varësisht se ku ka udhëtuar apo qëndruar ai.

Në fjalor, në aspektin morfologjik, dominon përdorimi i emrave dhe foljeve, e në një masë të konsiderueshme edhe i ndajfoljeve, mbiemrave, përemrave dhe numërorëve, si dhe pjesë të tjera të ligjëratës. Në *Fjalorthin serbokroatisht-shqip*, jep më shumë opsione ose sinonime të fjalëve, madje edhe shumë kontekste të përdorimit të tyre, që përveç se ndihmojnë të kuptohen më mirë fjalët, *Fjalorthin* e bën më të pasur dhe më të përdorshëm si përmbajtje.

Lëshimet i kami hasur kryesisht në kontekstin fonetik dhe në atë morfologjik. Në aspektin fonetik, vërehet se ka ndikuar më tepër keqkuptimi ortoepik, që është reflektuar pastaj në aspektin ortografik, kurse në aspektin morfologjik, hasim më pak lëshime, mirëpo më të zakonshmet janë ato te disa pjesë të ligjëratës si: përemra, mbiemra, ndajfolje, etj. Në aspektin semantik, ka më rrallë shkarje të tilla, për më tej që fjala është kryesisht në *Fjalorthin* e dytë.

Conclusion

Emanuel Krajinović (1891-1981) is one of the prominent personalities of the political, intellectual, and religious life of the Croatian world, but at the same time one of the prominent personalities with special contributions to Kosovo, its political issue, and perspective. The author of these two lexicographical manuscripts Small Albanian - Serbo Croatian Dictionary and Small Croatian Serbian - Albanian Dictionary (Original: “Mali rječnik albansko-srpskohrvatski” and “Mali rječnik hervatskosrpski albanski”), we can not say that he has made a great contribution to the field of lexicography, and yet will be remembered for their dialectical richness and the kindness of their preparation in a very dark situation in the scientific, cultural and national life of the Albanian people under Yugoslavia.

This dictionary is dominated by words and expressions mainly of ordinary life, everyday life, words from different fields such as agriculture, names of animals and plants, food, clothing, words of the religious or spiritual aspect, names for various means, places, professions, etc., which will have served them well enough for daily communication. What we notice in Emanuel Krajinović's dictionaries is also the marking of the long vowels. Dr. Emanuel Krajinović, it is noticed that he used different dialectal forms, given that at the time when he stayed in Kosovo, the standardization of the Albanian language had not yet taken place, therefore there is a varied use of forms of Albanian dialects not only of Kosovo, depending on where he traveled or stayed.

We have encountered omissions mainly in the phonetic and morphological context. In the phonetic aspect, it is noticed that the orthoepic misunderstanding has influenced more, which is then reflected in the orthographic aspect, while in the morphological aspect, we encounter fewer omissions, but the most common are those in some parts of the lecture such as pronouns, adjectives, adverbs, etc. In semantic terms, there are fewer such omissions, further that the word is mainly on the second vocabulary.